



<b>Datë/a:</b>	08.03.2017.
<b>Për/ Za/ To:</b>	Grup i Operatorëve Ekonomik: "KOMPANI E SIGURIMIT ALPHA PRIVATE SECURITY"; "SAS" sh.p.k.
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.03.2018 të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "KOMPANI E SIGURIMIT ALPHA PRIVATE SECURITY"; "SAS" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**", me Nr. të Prok: **616 17 148 211** nxjerr:

## V E N D I M

- Aprovohet pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri vlerësim e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "KOMPANI E SIGURIMIT ALPHA PRIVATE SECURITY"; "SAS" SH.P.K. e parashtruar me datë: 06.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**", me Nr. të Prok: **616 17 148 211**, kundër **Njoftimit për dhënie të Kontratës** të AK –së, të datës **02.03.2018** të publikuar në web-faqe të KRPP-së lidhur me pretendimin se: Operatori Ekonomik fitues **nuk ka dhënë dëshmi lidhur me kopjet e licencave për punëtorët e angazhuar** (para njoftimit për dhënie të kontratës).
- Autoriteti Kontraktues, vendos që Komisioni i Rivlerësimit të ri-ekzaminoj edhe njëherë **ofertën e Grupit të Operatorit Ekonomik të "K.S.AS - SECURITY" SH.P.K.; "KOMTEL PROJECT ENGINEERING" SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**", me Nr. **616 17 5437 211** Nr. Brendshëm **616 17 148 211** dhe të kërkoj nga i njëjti dëshmitë për punëtorët e licencuar sipas kërkesave në Formularin e Dosjeve të Tenderit (FTD);
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## **A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 25.12.2017 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: "*Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës*", me Nr. **616 17 5437 211** Nr. Brendshëm **616 17 148 211**.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 05.02.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 02.03.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 05.03.2018, Grup i Operatorëve Ekonomik: "KOMPANI E SIGURIMIT ALPHA PRIVATE SECURITY"; "SAS" SH.P.K., iu ka lejuar çasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Grup i Operatorëve Ekonomik: "KOMPANI E SIGURIMIT ALPHA PRIVATE SECURITY"; "SAS" SH.P.K. të dt. 25.12.2017 lidhur me aktivitetin e prokurimit "*Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës*", me Nr. **616 17 5437 211** Nr. Brendshëm **616 17 148 211**, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK -së, të datës 02.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/ A, te paragrafit 1,2,3,4,5,6,7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, dhe në kërkesat për pjesëmarrje në dosjen e tenderit në të cilin theksohet:

**a) Kërkesa 3: OE DUHET TE DEKLAROH SE DO TI SIGUROJ LICENSAT PER PUNETORET E ANGAZHUAR**

**a) Dëshmia: 3.DEKLARATA E NENSHKRUARA DHE E VULOSUR (FITUESI I TENDERIT DUHET TE SJELL KOPJET E LICENSAVE (Para publikimit te njoftimit te dhënies së kontratës).**

Poashtu Operatori Ekonomik ka dhënë pretendimet e tij lidhur me atë se Operatori Ekonomik fitues nuk e ka sjellur **Vërtetimin Tatimor dhe Vërtetimin nga Gjykata**, për këtë Autoriteti Kontraktues refuzon kërkesën për këtë pretendim pasi që Operatori Ekonomik fitues ka sjellur dëshmitë e kërkuara dhe janë në dosje.



Për sa i përket pretendimit të Operatorit Ekonomik lidhur me pjesën C të formularit të FDT-së se Operatori Ekonomik fitues nuk e ka plotësuar, Autoriteti Kontraktues thekson se kjo nuk qëndron përshkak se Operatori Ekonomik fitues ka plotësuar pikën 6 të formularit të tenderit së bashku me partnerin në konzorcium duke vënë identitetin e partnerit konzerciones.

Prandaj duke i marrë parasysh dhe vlerësuar provat nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

*Vërejtje: Autoriteti Kontraktues do të iu njofton me kohë me rekomandimin e Komisionit për vlerësim.*

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

